

30 DITË në AMA

DËRGO ANKESË PËR RADIO DHE TELEVISIONE



Lufta kundër piraterisë, 220 inspektime të kryera gjatë vitit 2024

Gjatë vitit 2024 ekipet e inspektimit të AMA-s kanë kryer 315 kontrolle kontrolle të aktivitetit të



Kryetarja e AMA-s në Forumin për të Drejtat e Njeriut: Gjuha e urrejtjes, shqetësim mbarë botëror




Transmetimi i pamjeve të dhunshme, AMA merr 9 masa për televizionet


Në ditët e para të muajit janar, Autoriteti i Mediave Audiovizive, ka marrë 9 masa "Tërheqje vëmendje", për 9 televizione...

Zgjedhjet e Majit, Kryetarja Z.Krasniqi pret përfaqësuesit e KRIIK

Kryetarja e AMA-s, Znj.Armela Krasniqi priti në një takim përfaqësues të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)...



SHKELJE TE EVIDENTUARA GJATE MONITORIMIT TË PËRMBAJTJEVE



Shkeljet në përmbajtjet audiovizive, AMA shqyrton 241 raste

Gjatë vitit 2024, janë verifikuar dhe shqyrtuar 241 raste të përmbajtjeve audiovizive për përputhshmërinë me kërkesat ligjore dhe standardet etike. Ekipet e monitorimit dhe...

Kryetarja e AMA-s në Forumin për të Drejtat e Njeriut: Gjuha e urrejtjes, shqetësim mbarë botëror

Kryetarja e AMA-s, Znj. Armela Krasniqi mori pjesë në Forumin për të Drejtat e Njeriut, HR30, "EMPOWER TALK: Qëndresa Kundër Urrejtjes & Përqafimi i të Drejtave", organizuar në Tiranë nga Qeveria Shqiptare dhe Universiteti Essex në Angli. Në fjalën e saj Znj. Krasniqi është shprehur se, gjuha e urrejtjes është kthyer në shqetësim mbarë botëror ndërsa prezantoi një panoramë të punës që ka bërë AMA në këtë drejtim. "Ne kemi punuar duke u mbështetur në disa shtylla: reformat



ligjore, përafrimi me legjislacionin e BE dhe ndjekja e shembujve perëndimorë, respektimi e të Drejtës për Informim dhe Edukimin Mediatik të Publikut, si investimi më i mirë për krijimin e një audience të mençur dhe vendimmarrëse"- u shpreh Kryetarja e AMA-s. [Lexo më shumë](#)



Lufta kundër piraterisë, 220 inspektime të kryera gjatë vitit 2024

Gjatë vitit 2024 ekipet e inspektimit të AMA-s kanë kryer 315 kontrolle të aktivitetit të OSHMA-ve. Nga këto, 220 janë inspektime të kryera për Pirateri dhe 95 për monitorim të frekuencave. Lufta kundër fenomenit të Piraterisë televizive, që kryhet nga subjekte të paautorizuar nga AMA për ofrimin e shërbimit audioviziv, është një nga objektivat kryesor të punës të AMA-s. [Lexo më shumë](#)



Transmetimi i pamjeve të dhunshme, AMA merr 9 masa për televizionet

Në ditët e para të muajit janar, Autoriteti i Mediave Audiovizive, ka marrë 9 masa "Tërheqje vëmendje", për 9 televizione të ndryshëm, kjo për shkak të transmetimit të pamjeve të dhunës dhe gjuhës të papërshtatshme përdorur në to. Kryetarja e AMA-s, Znj. Armela Krasniqi. "Shfaqja e dhunës në transmetimet televizive duhet të marrë fund. Publiku shqiptar ka të drejtën e tij të jetë i mbrojtur nga ekspozime të tilla të panevojshme dhe profesionistët e medias nuk duhet ta harrojnë këtë", ka thënë ajo.

[Lexo më shumë](#)


Zgjedhjet e Majit, Kryetarja Z.Krasniqi pret përfaqësuesit e KRIIK



Kryetarja e AMA-s, Znj. Armela Krasniqi priti në një takim përfaqësues të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK). Thelbi i takimit mes tyre ishte puna që do të bëhet gjatë fushatës zgjedhore. Kryetarja e AMA-s, Znj. Krasniqi u shpjegoi përfaqësuesve të KRIIK, punën monitoruese të AMA-s gjatë procesit zgjedhor si dhe metodologjinë që përdoret, sipas përcaktimeve të KQZ-së.

[Lexo më shumë](#)

MONITORIMIT TË PËRMBAJTJEVE



Shkeljet në përmbajtjet audiovizive, AMA shqyrton 241 raste

Gjatë vitit 2024, janë verifikuar dhe shqyrtuar 241 raste të përmbajtjeve audiovizive për përputhshmërinë me kërkesat ligjore dhe standardet etike. Ekipet e monitorimit dhe analizës së përmbajtjeve në AMA, kanë identifikuar disa lloje shkeljesh, si: Mbrojtja e fëmijëve nga përmbajtjet e papërshtatshme, mosrespektimi i programacionit sipas kushteve të licencës/autorizimit, përdorimi i gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit, etj.

[Lexo më shumë](#)

